

Përse një Kushtetutë të Re

1. Për të kthyer Shqipërinë në një vend normal
2. Për ti kthyer qytetarëve kontrollin e shtetit zaptuar nga partitë
3. Për të larguar oligarkët në politikë dhe monopolet në ekonomi
4. Për të luftuar korrupsionin dhe siguruar në praktikë të drejtat themelore
5. Për të ndalur hemorragjinë kombëtare dhe afruar në vend miliona shqiptarë që e kanë braktisur

Shqipëria nuk është një vend normal. Në sytë e të gjithëve kuptohet që nuk bëhet më fjalë për një krizë tranzicioni të përkohshme por përjetësim i një sistemi të ngritur mbi privilegje, padrejtësi dhe mediokritet.

Pavarsisht propagandës sistemike, Shqipëria po i largohet Europës dhe çdo ditë e më shumë po humbet garën me fqinjët në demokraci, ekonomi, infrastrukturë, arsim, art dhe kulturë. Por akoma më keq ajo që po humb është besimi i shqiptarëve për të ndërtuar të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve në këtë vend.

Kjo gjendje e mjeruar nuk është fenomen natyror por vepër e pak njerëzve që kanë zaptuar shtetin dhe bashkë me të demokracinë dhe ekonominë. Pra Shqipëria nuk vuan thjesht nga korrupsioni si në vendet e tjera, por jeton brenda korrupsionit të një shteti të kapur. Kushetuta, ligjet, dhe çdo institucion është në duart e një kaste që riprodhohet mbi një ADN antidemokratike.

Shteti nuk punon më për qytetarët sepse nuk kontrollohet më nga qytetarët. Zgjedhjet janë formale, qeverisja bëhet mbi të kundërtën e premtimeve elektorale dhe rotacionet politike po përkeqësojnë vazhdimisht situatën.

Në kushtet ku populli sheh se të drejtat e tij themelore janë shpronësuar dhe sovraniteti është zaptuar, i lind e drejta për një kontratë të re sociale. Një kushtetutë të re për normalizimin e vendit, ku në qendër nuk janë më partitë por vetë qytetarët që marrin pjesë aktive në jetën politike dhe ekonomike të vendit.

Kushtetuta e re nuk do të mund të merret peng nga asnjë individ apo grupim sepse ajo mban shtetin të togëzuar me vullnetin e sovranit, vendos drejtësinë formale dhe sociale, kthen dinjitetin e njeriut, zhduk tendencat oligarrike, largon kaosin dhe kthen llogaridhënien, zhduk korrupsionin dhe kthen të drejtat, zhduk privilegjet dhe kthen meritën, zhduk injorancën dhe kthen dijen, i jep fund përçarjeve dhe kthen bashkimin mes shqiptarëve.

Populli shqiptar nuk meriton këtë shtet dhe këtë klasë politike!

Populli shqiptar meriton të jetojë në një vend normal si çdo popull tjetër europian!

Populli shqiptar është ndër popujt më të vjetër dhe më krenarë të këtij kontinenti!

Vlerat e shqiptarisë na lejuan mbijetesën ndër shekuj në sfida edhe më të mëdha se e sotmja!

Rigjejmë këto vlera dhe nisim së bashku rrugëtimin demokratik drejt një të ardhme më të mirë!